VENDIM
Nr.253 datë 22.6.1992

PËR FILLIMIN E DISA MASAVE TË PROGRAMIT TË REFORMËS EKONOMIKE

Me propozim të Bankës së Shqipërisë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe të Miistrisë së Tregtisë së lidhjeve ekonomike me jashtë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Për kurset e këmbimit të valutave

1. Të zbatohen norma të ndryshueshme interesi për depozitat dhe kreditë duke u mbështetur në ecurinë e inflacionit dhe në kërkesat e tregut.

2. Të zbatohet një sistem i lirë i kurseve të këmbimit që do të veprojnë me kuota ditore të tregut të këmbimit valutor.

3. Zbatimi i masave të mësipërme është objekt i politikës monetare që drejton Banka e Shqipërisë.

II. Për liberalizimin e regjimit të tregtisë së jashtme

1. Të liberalizohet thellësisht regjimi i tregtisë së jashtme.

Për këtë:

a) Të hiqen kërkesat për licensa dhe kontrollet sasiore për pjesën më të madhe të mallrave për eksport, me përjashtim të disa mallrave ushqimore që mbeten me çmime të kontrolluara dhe që hyjnë në grupin e ndihmës ushqimore nga jashtë si dhe të artikujve me vlera të veçanta.

b) Të hiqen kufizimet e licencimet e importit me përjashtim të atyre që kanë lidhje me mbrojtjen e ambienmtit dhe me interesat e sigurimit e të mbrojtjes së vendit.

c) Të hiqen monopoli i të gjitha organizmave shtetërore në lidhje me tregtinë e jashtme.

Ministritë dhe institucionet përkatëse të marrin masat e nevojshme për zbatimi e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi me 1 korrik 1992.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi